



**PROCESVERBAL I DEBATIT PUBLIK
NË LIDHJE ME KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE
(KAB) 2025-2027 – GORANCË**

Procesverbali nga Debati i parë publik në lidhje me Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025 - 2027 u zhvillua me datën **14.06.2024** duke filluar nga ora 11:00 në SHFMU “Veli Ballazhi” në Gorancë, në të cilin ishin gjithsej 20 pjesëmarrës, prej të cilëve 4 ishin gra dhe 16 burra.

Debatin publik nga Zyra e Kryetarit të Komunës e kryesoi Kryetari i Komunës, i cili i përshëndeti të pranishmit dhe i falënderoi për pjesëmarrjen e tyre, ndërkaq morën pjesë edhe drejtor e drejtoresha të drejtorëve të Komunës, ku për rend të ditës kishin:

- 1. Prezentimi i Draft Kornizës Afatmesme Buxhetore**
- 2. Diskutimi i hapur**

Mehmet Ballazhi: Sot jemi këtu për ta diskutu Kornizën Afatmesme Buxhetore që është planifikimi fillestar i buxhetit, e poashtu edhe dëgjimet fillestare, e më pas do të jenë edhe dëgjimet tjera finale për Draft buxhetin që i paraprin buxhetit që miratohet nga Kuvendi Komunal deri me 30 shtator. Pra në këto dëgjime, jemi në fazën e parë të projekteve të buxhetit, e më pas vijohet me fazat tjera, si faza e hartimit të projekt buxhetit, miratimit të tij në Kuvend Komunal e në fund edhe miratimit në Qeveri. Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025-2027 do ta prezentojë Drejtorja për Buxhet dhe Financa, **znj.Lindita Ballazhi**.

1. Prezentimi i Draft Kornizës Afatmesme Buxhetore

Lindita Ballazhi: Duke u bazuar në Ligjin për Financa Publike dhe Përgjegjësitë, Qeveria e Kosovës gjatë muajit maj të këtij viti ka aprovuar Kornizën Afatmesme të shpenzimeve qeveritare të planifikimeve 2025-2027 apo KASH-in për periudhën 2025-2027, ku në bazë të Kornizës Afatmesme Buxhetore të shpenzimeve qeveritare, nivelit lokal iu përcjellat Qarkorja e parë buxhetore dhe me kufijtë fillestarë në nivel të Kosovës. Me pranimin e Qarkores së parë buxhetore, ne kemi hartu grupin punues për hartimin e KAB-it, në të cilin kemi kufijtë fillestarë buxhetore me të cilat ne bëjmë planifikimin e buxhetit për vitin vijues apo konkretisht për vitin 2025, si dhe vlerësimet e hershme për vitin 2026-2027, me ç'rast ne bëjmë hartimin e shpenzimeve duke renditur prioritetet kryesore komunale dhe normalisht objektivat të cilat janë të identifikuar në dokumente strategjike komunale dhe më pas e përcjellim në KPF dhe Kuvend Komunal, mbajmë dëgjimet buxhetore siç edhe jemi mbledhur këtu sot, ku ne marrim

kërkesat, sugjerimet, rekomandimet dhe prioritetet tuaja, prej të cilave ne e bëjmë një listë me propozimet e qytetarëve dhe e përcjellim si material shtesë në Kuvendin Komunal, së bashku me KAB-in dhe Kuvendi Komunal voton për projektet që dorëzohen e që ata i shohin më me rëndësi. PAs kësaj faqe, vijohet me fazën tjetër e cila ka të bëjë me miratimin e KAB-it në Kuvend Komunal deri me 30 qershor. Pas miratimit të LKAB-it, pasohet me fazën tjetër e cila ka të bëjë me paranimin e Qarkores së dytë buxhetore e cila kërmbanë kufijtë final buxhetor deri me 15 gusht, ku me pranimin e kësaj Qarkore, hartohet një draft buxhet, e pastaj përsëri mbahen dëgjime buxhetore, dorëzohet në Kuvend Komunal bashkë me propozimet finale të qytetarëve deri me 1 shtator dhe më pas është faza e miratimit të buxhetit nga Kuvendi Komunal deri me 30 shtator. Buxheti i miratuar nga asambleja komunale dërgohet në Departament të Buxhetit, gjegjësisht në Ministrinë e Financave, Punëve dhe Transfereve. Për vitin 2025, në bazë të Qarkores së parë buxhetore 01/2025, buxheti i Komunës parashihet të jetë 3,615,457.00 € , këtu kemi përfshirje të 4 burimeve të financimit: nga Granti i Përgjithshëm me pjesëmarrje prej 1,701,892.00 € apo 47.07%, nga Granti Specifik i Arsimit me pjesëmarrje 1,167,634.00 € apo 32.29%, nga Granti Specifik i Shëndetësisë me pjesëmarrje 406,212.00 € apo 11.23% , nga të Hyrat Vetanake Komunale me pjesëmarrje prej 339,719.00 € apo 9.39%, pra totali (Grantet + THVK) me pjesëmarrje prej 3,615,457.00 € apo 100.00 %. Në tabelat e paraqitura në KAB gjeni edhe Planin afatmesëm të të hyrave të buxhetit komunal për vitet 2025-2027, Planin e ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale për vitin 2025, si dhe Listën e Projekteve Kapitale, Ndërkaq tani presim projekt propozimet tuaja për vitin buxhetor 2025.

2. Diskutimi i hapur

Shefket Lusnjani – Administrator i fshatit Gorancë (Kryetar i Shoqatës së Pensionerëve): Ne si kryesi e Këshillit Lokal të Gorancës, ne kemi hartu një listë me kërkesat tona që i kemi si prioritetet:

1. Rruga ByPass që lidh Glloboçicë – Gorancë – Hani i Elezit, ku për këtë rrugë rreth viteve 2000-2001 kemi bërë nënshkrimin e një pëlqimi për me lëshu pronën për rrugën, e tash duhet me u bo prapë një tjetër.
2. Rruga për te Lapidari i Dëshmorëve “Feriz dhe Xhevdet Guri” , ku ne rregullisht kemi bërë rrafshimin e kësaj rruge ku na ka ndihmu edhe Achro, dhe ne kërkojmë që kjo rrugë të fillojë prej te varrezat nga edhe është bërë furnizimi me armatim për Brigadën 164 “Gafurr Loku”, diku është rreth 2 km.
3. Kanalizimi te Lagjja e Musallarëve, për afërsisht 8 shtëpi janë për më u lidh te gypi kryesor, dhe këto shtëpi hala janë pa kanalizim
4. Kanalizimi te Lagjja Barmallarët, ku janë 6 shtëpi, e njëjta si kërkesa e mësipërme.
5. Kemi tre lagje që janë rrugët e pashtruara me kubëza betoni
6. Kërkojmë të bëhet një hulumtim të ujit me rënie të lirë apo ujit të pijes.
7. Kërkesë e diasporës , konkretisht nga Hazbi Berisha dhe e rinisë tonë për ndërtimin e një pishine te vendi i quajtur Gjurë, që të freskohen, aty ka pas punime por duhen me u bo disa riparime
8. Një shëtitore prej fshatit deri te Qamat, ku kërkojmë të shtrohet me kubëza betoni, të vendoset ndriçimi, ulëse, shporta për mbeturina, gjithashtu kërkojmë të bëhet shpimi i ujit ose të sjellim ujë me rënie të lirë.

9. Kemi vërejte te Kompania Pastrimi se nuk po i merr kontenjerët e mbeturinave te pishat, ku në mënyrë vullnetare është duke u bërë pastrimi i vendit komplet
10. Mirëmbajtjen e shportave të mbeturinave në fshat, kërkojmë që ta merrë përsipër kompania Pastrimi
11. Një kërkesë prej 4 vjete nga fshati Rezhancë është që te varrezat e fshatit Rezhancë të shtrohet me kubëza betoni.

Mehmet Ballazhi: Siç e dini, ne i kemi diku 600 mijë € investime kapitale. Të gjitha këto propozime janë të nevojshme, por e pamundur që me u realizu, e kam fjalën për projektet kapitale, ndërsa të tjerat siç janë vendosja e shportave, e të ngjajshme, këto janë shërbime publike dhe nuk besoj se mund të jenë problem. Megjithatë ne do t'i marrim propozime tuaja dhe ato që janë më prioritet, ne do t'i fusim në listën e projekteve. E më pas normalisht është edhe Kuvendi Komunal që janë 15 anëtarë që i votojnë projektet. Por ne do të japim maksimumin tonë, shembull rruga te varrezat në Rrezhancë është shumë e nevojshme, ose për ByPassin e dini që bashkë me nënkryetarin kemi tentu me FSK s'paku ata me na e hapë trasën, e për me pas atë duhen nënshkrimet, duhen vijat se kah duhet kalu rruga dhe tash ky proces duhet fillu prapë nga fillimi.


Naser Kaloshi – banor i fshatit Gorancë: Problem të madh që e kemi në Gorancë është rryma, ku ka ndërprerje të shpeshtë të saj, e që neve na shkakton shumë probleme, ku mundet me ndodh ndonjë defekt e disa ditë ne jemi pa rrymë, e po na djegin pajisjet, ata që janë me bunarë kur s'kanë rrymë, s'kanë as ujë. Unë kërkoj që ju si institucion me marrë masa ndaj këtij problemi, me kontakti me KEDS-in që me u rregullu ky problem.

Mehmet Ballazhi: Çështja e rrymës po KEDS-it nuk është në domenin tonë komunal, por është në KEDS dhe në institucionet qendrore. Ajo që ne mund ta bëjmë është që të adresojmë shqetësimet tuaja tek ata, pra me u bo urë lidhëse mes juve dhe atyre, me qëllim për me u përmirësu jetesë me këto gjana që janë elementare.

Lindita Ballazhi: Ne kemi mbajtur procesverbal të këtij debati dhe të gjitha propozime tuaja do të shqyrtohen sërish. Nëse dikush ka ndonjë pyetje tjetër apo propozim, mundeni edhe të më drejtorheni në emailin tim Lindita.ballazhi@rks-gov.net apo edhe kërkesat tuaja ti dërgoni fizikisht tek Qendra për Shërbim me Qytetarë, e më pas ne do t'i shqyrtojmë të gjitha kërkesat, sugjerimet, rekomandimet dhe propozimet tuaja, si ato gjatë këtij debati, ashtu edhe ato përmes emailit dhe përmes dërgimit të QSHQ. Nëse nuk ka tjetër diskutim apo propozim, e konsideroj të mbyllur debatin publik.

Debati publik përfundoi në orën 12:15.







REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT



LISTA E PJESËMARRËSVE NË DËGJIMIN BUXHETOR PËR KORNIZËN
AFATMESME BUXHETORE 2025-2027

Lokacioni: SHFMU "Veli Ballazhi"
Data: 14.06.2024
Ora: 11:00

NR	EMRI DHE MBIEMRI	NUMRI KONTAKTUES	NËNSHKRIMI
1	Shakir Durvica	[REDACTED]	[REDACTED]
2	MAKIB BERISHA	[REDACTED]	[REDACTED]
3	Naser Kaloshi	[REDACTED]	[REDACTED]
4	GENAN BERISHA	[REDACTED]	[REDACTED]
5	Rashid Lushjani	[REDACTED]	[REDACTED]
6	Selman Vila	[REDACTED]	[REDACTED]
7	ARSIM DERUJANI	[REDACTED]	[REDACTED]
8	Abdurrmanan Bushi	[REDACTED]	[REDACTED]
9	Arson Dur	[REDACTED]	[REDACTED]
10	ABULLA BERISHA	[REDACTED]	[REDACTED]
11	RENZI BERISHA	[REDACTED]	[REDACTED]
12	Islam Vila	[REDACTED]	[REDACTED]
13	Abdullmejid Wajez	[REDACTED]	[REDACTED]

14	LIRIDONA BALLAZHI	[REDACTED]	B. Ballazhi
15	MAJLINDA KALOSHI	[REDACTED]	M. Kaloshi
16	ARBENITA BAJRAMALIKU	[REDACTED]	Bajrami
17	IBRAHIM, - BERISHI	[REDACTED]	Berish
18	BISHM KALOSHI	[REDACTED]	B. Kaloshi
19	Faik Vila	[REDACTED]	F. Vila
20	LINDITA BALLAZHI	[REDACTED]	L. Ballazhi
21			
22			
23			
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			